

VENDIM
Nr. 46, datë 27.11.2015

**PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN, NR. 1, DATË 19.1.2015, TË KOMITETIT PËR
ZHVILLIMIN E RAJONEVE**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 15 e të aneksit 3, të ligjit nr. 185, datë 28.12.2013, “Për buxhetin e vitit 2014”, Komiteti për Zhvillimin e Rajoneve

VENDOSI:

1. Në pikën 1, germa “b”, të vendimit nr. 1, datë 19.1.2015, “Për përcaktimin e drejtimeve prioritare të investimeve dhe miratimin e dokumentit strategjik operacional për Fondin e Zhvillimit të Rajoneve, 2015–2016”, bëhen ndryshime, si më poshtë vijon:

- Vlera totale e grantit konkurrues për programin “Shqipëria dixhitale”, për vitin 2015, nga 2 189 000 000 (dy miliardë e njëqind e tetëdhjetë e nëntë milionë) lekë, bëhet 2,207,000,000 (dy miliardë e dyqind e shtatë milionë) lekë.

2. Ngarkohen ministri i Shtetit për Inovacionin dhe Administratën Publike, ministri i Financave dhe Sekretariati i Përgjithshëm i Komitetit për Zhvillimin e Rajoneve, në Kryeministri, për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Edi Rama

Zëvendëskryeministri	zëvendëskryetar;
Ministri i Financave	anëtar;
Ministri i Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes	anëtar;
Ministri i Zhvillimit Urban	anëtar;
Ministri i Transportit dhe Infrastrukturës	anëtar;
Ministri i Arsimit dhe Sportit	anëtar;
Ministri i Shëndetësisë	anëtar;
Ministri i Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe	
Administrimit të Ujërave	anëtar;
Ministri i Kulturës	anëtar;
Ministri i Mjedisit	anëtar;
Ministri i Punëve të Brendshme	anëtar;
Ministri i Shtetit për Inovacionin dhe Administratën Publike	anëtar;
Ministri i Shtetit për Çështjet Vendore	anëtar;
Kryetari i Shoqatës së Qarqeve të Shqipërisë	anëtar;
Kryetari i Shoqatës së Bashkive të Shqipërisë	anëtar;
Kryetari i Shoqatës për Autonomi Vendore	anëtar.